



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:054924

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485886

PPP.nr.1634/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, me seli në Prishtinë, rr.Bill Klinton, kundër debitorit Fa.G nga Lipjani, rr. 1 nr....., lidhur me çështjen përmbarimore pagesë e borxhit, vlera 631.45€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.393/2019, të datës 12.07.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha nga Prishtina, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorit F.Gj nga L , ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht urdhëri përmbarimor P.nr.393/2019, i datës 12.07.2019 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha në Prishtinë dhe atë për periudhën 01.04.2014 deri me datë 31.12.2017, në shumë prej 603.25€.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit F.G nga L, ashtu që Urdhëri Përmbarimor P.nr.393/2019, i datës 12.07.2019 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha në Prishtinë, MBETET në fuqi për periudhën 31.01.2018 deri me datë 30.06.2018, për shumën e borxhit 28.20€, deri në përmbarim të përfundimtar të detyrimit.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguaj garancionin në xhirollogarinë e kësaj gjykate në shumën prej 28.20€ (Euro).
- IV. Në rast se debitori dështon të paguaj shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Fadil I Hoxha nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhëri me të cilin ka lejuar përmbarimit në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist me ID nr.49786 në emër të debitorit F.G për periudhën kohore nga data 01.01.2014 deri me datë 30.06.2018, me të cilin ka kërkuar që debitorit të obligohet të ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 631.45€, të gjitha detyrimet të përmbushen përmes bllokimit të llogarisë bankare apo regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme të debitorit dhe përmes shitjes së tyre deri në vlerën e borxhit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërsi urdhrin për përmbarim për arsyeje se i njëjti ka të meta juridike pasi që dokumenti mbi bazën e të cilit është marr ky urdhër e ka humb efektin e tij përkatësisht është pa efekt juridik. Tutje ka shtuar se shuma prej 631.45€ është borgj i vitit 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2017 dhe i gjithi borxh i kërkuar nga kreditori është i përfshirë në parashkrim të kërkesës në bazë të nenit 360 par. 1 pika 1.1 i LMD-së. Duke shtuar se kreditori e ka lëshuar afatin ligjor brenda të cilit ka mund të paraqes kërkesën për pagim të borxhit, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërsi i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhëri përmbarimor P.nr.393/2019 i datës 12.07.2019 dhe të refuzohet si i pabazuar propozimi për përmbarim.

Kreditori ka paraqitur përgjegje në prapësim ku ka theksuar se debitori nuk ka dhënë asnjë arsye bindëse për të qenë i vlefshëm ky prapësim. Lidhur me parashkrimin e kërkesës kreditori ka theksuar se se kjo nuk qëndron për shkak se në bazë të kartelës së konsumatorit vërtetohet se debitori në intervale të caktuara kohore ka kryer pagesa me qka vërtetohet se debitori ka qenë gjithmonë në dijeni për shërbimet e kryera nga kreditori duhet të kryhet pagesa, andaj debitori duke kryer pagesa të kohëpaskohshme edhe ka bërë ndërprerje të parashkrimit në bazë të nenit 368 të LMD-së. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërsi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditores dhe pas studimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm – ekstraktin e verifikuar nga librat afarist 49786, dt.10.07.2019 në emër të F.G, për periudhën 01.01.2014 deri 30.06.2018, në bazë të së cilës organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin dhe ka vlerësuar se i njëjti paraqet dokumente të besueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe pas analizimit të këtyre pretendimeve në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit.

Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat*

shtëpiake”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Kurse me nenin 368 paragraf 1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) përcaktohet se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Po ashtu edhe me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se, kërkesat nga shërbimet e pastrimit parashkruhen brenda afatit prej një viti, ndërsa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin kërkesa arrin për pagesë. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim, se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të LMD-së. Kreditori ka kërkuar përmbarrimin e borxhit për periudhën nga data 01.01.2014 deri me datë 30.06.2018, ndërsa propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datë 12.07.2018. Bazuar në këtë, rezulton se borxhi i kreditorit është pjesërisht i parashkruar, dhe atë për periudhën 01.01.2014 deri me datë 31.12.2017 kjo për faktin se nga dita kur janë bërë të arritshme kërkesat periodike për këtë periudhë, e deri në ditën kur është paraqitur propozimi për përmbarrim, për të gjitha kërkesat prej datës 01.01.2014 deri me datë 31.12.2017 ka kaluar më shumë se një vit, andaj gjykata konstaton se në rastin konkret lidhur me periudhën kohore të cekur si më lartë kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo për faktin se ka kaluar koha e paraparë me ligj brenda të cilit kreditori mund të kërkojë përmbarrimin e detyrueshëm të kërkesës së tij karshi debitorit.

Deri tek shuma prej 28.20€ për të cilën propozimi për përmbarrim është lënë në fuqi respektivisht shuma 603.25€ për të cilën është shfuqizuar urdhëri përmbarrimor, gjykata erdhi për faktin se kërkesa e përgjithshme e kreditorit është 631.45€ dhe nga llogaritja e faturimeve për periudhën 01.01.2018 deri me 30.06.2018 për të cilën gjykata vlerëson se nuk ka parashkrim të kërkesës del shuma prej 28.20€, dhe kur nga shuma e përgjithshme prej 631.45€ minusohet shuma prej 28.20€ për të cilën nuk ka parashkrim të kërkesës, del shuma prej 603.25€ për të cilën shfuqizohet urdhëri përmbarrimor, respektivisht shuma prej 28.20€ dhe për të cilën urdhëri përmbarrimor P.nr.393/19 i dt.12.07.2019 mbetet në fuqi.

Në momentin e vendosjes gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e kreditorit të ngritura në përgjigje në prapësim lidhur me atë se debitori me kryerjen e disa pagesave të kohëpaskohshme ka bërë pranimin e borxhit, mirëpo gjykata këtë pretendim e vlerëson të pabazuar për faktin se nga pasqyra e konsumatorit vërtetohet se pagesa e fundit e debitorit është kryer me datë 11.07.2011, ndërsa propozimi për përmbarrim është parashtruar me datë 12.07.2019, andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret afatet e parashkrimit kanë filluar të rrjedhin sërish edhe përkundër ndërprerjes së pretenduar me pagesën e një pjese të borxhit.

Për më tepër edhe sipas interpretimeve dhe konstatimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të dhëna në aktgjykimin e saj Rev.nr.148/2012, dt.09.09.2013, në një rast tjetër gjyqësor, me rastin e sqarimit të çështjes së ndërprerjes së parashkrimit me pagimin e borxhit, e njëjta gjykatë sqaron se edhe pagesat e bëra të kohë pas kohe lidhur me borxhin periodik, nuk e bën ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ngase në rastin konkret borxhi për shpenzimet e

energjisë elektrike është borxh periodik i cili arrin pas përfundimit të çdo muaji dhe afati i paraparë në nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, për parashkrim rrjedh për secilin muaj nga momenti i përfundimit të atij muji, që do të thotë parashkrimi tek borxhi periodik që ka të bëjë me shpenzimin e energjisë elektrike, llogaritet në secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Gjykata vlerëson se pjesërisht janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: . ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi”*, e që në rastin konkret të çështjes juridike në fjalë është vërtetuar se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditores.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin vendosi që ta aprovoj pjesërisht në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe vendosi si në pikën I, kurse pjesën tjetër të prapësimit e refuzoj si të pabazuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitorin që në rast të parashkrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 28.20€, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi debitorin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.1634/19, dt.21.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.